

UP-ja INTENSIFIKON PËRGATITJET PËR TË SJELLË RISI NË ARSIM

# Plus 4 programe TË REJA NË MASTER



## Programet do të vlerësohen...

Bud Dedaj, drejtor rajonal i VUS Austria në Prishtinë, ka thënë se projekti për organizim të studimeve master është në fazë përfundimtare. Ndonëse ky projekt ka marrë vlerësim pozitiv nga ekspertët austriakë, ai do t'i dërgohet për vlerësim edhe Agjencisë për Akreditim të Kosovës, të cilën do të japin dritën jeshile për akreditim apo jo të këtij programi.

Universitetin e Prishtinës. Në katër fakultete do të organizohen studime master në drejtime të reja. Programet e këtyre studimeve janë miratuar edhe nga Senati i Universitetit, ndërsa do të financohen nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Fakultetet, të cilat do të pranojnë studentë të rinj në drejtime të reja, në nivelin master janë: Fakulteti i Mjekësisë - Drejtimi Menaxhment Shëndetësor, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Drejtimin Mekatorika, si dhe në Fakultetin Juridik master do të organizohen në 2 drejtime në të drejtën ndërkombëtare. Realizimi i këtyre programeve dhe organizimi i

## Në vitin e ardhshëm akademik, Fakulteti i Mjekësisë do t'i pranojë 30 studentë të rinj në nivelin master në Drejtimin Menaxhmenti Shëndetësor

studimeve master është arritur falë bashkëpunimit me universitetet të ndryshme ndërkombëtare. "Në shtator të këtij viti, Fakulteti i Mjekësisë do të regjistrojë 30 studen-

të të rinj në master në Drejtimin Menaxhmenti Shëndetësor. Këto studime do të zgjasin 2 vjet dhe kjo është arritur falë bashkëpunimit të mirë me universitetet të ndryshme evropiane si Universitetit të Mjekësisë në Vjenë dhe Universitetit të Gracit", ka theksuar prodekani i Fakultetit të Mjekësisë, Shemsedin Dreshaj. Ligjëratat për nivelin master siç u shpreh prodekani Dreshaj do të mbahen nga stafi akademik i UP-së, Universiteti i Vjenës si dhe përmes projektit kthimi i trurit ekspertët e ndryshëm kosovar që janë jashtë dhe pritet të japin kontributin e tyre në këtë drejtim. Bud Dedaj, drejtor rajonal i VUS Austria në Prishtinë, ka thënë se projekti për organizim të studimeve master është në fazën përfundimtare. Ndonëse ky projekt ka

marrë vlerësim pozitiv nga ekspertët austriakë, ai do t'i dërgohet për vlerësim edhe Agjencisë për Akreditim të Kosovës, të cilën do të japin dritën jeshile për akreditim apo jo të këtij programi. Dedaj ka thënë se Universiteti i Mjekësisë në Vjenë ka shprehur gatishmëri të madhe në kuadër të këtij programi të cilin do të drejtojnë tre profesorë për cikël të ligjërave. Këta profesorë ligjëratat do t'i orientojnë në formë të përbashkët me profesorët vendorë. Projekti do të financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim, kurse zbatues do të jenë VUS Austria. Ai ka nënvizuar faktin se në kuadër të 4 programeve të reja master që do të zbatohen nga UP-ja në ardhshëm akademik do të jenë të lëndë të reja mësimore. Kostot e këtyre projekteve do të jetë në shumicë mijë euro për secilin projekt. V. REXHA